



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta / Ministry of Culture, Youth and Sports

Prishtinë, mars 2025

THIRRJA PËR PROJEKT-PROPOZIMET PËR MBËSHTETJEN E AUTORIT

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), në fushën e librit për vitin 2025, rendit ndër prioritetet programore zhvillimin e librit përmes botimit, promovimit, përkthimit, digjitalizimit, nxitjes së lexueshmërisë.

MKRS e konsideron librin si një mjet të rëndësishëm për të nxitur kulturën, artin dhe krijimtarinë, dhe kjo thirrje synon të inkurajojë zhvillimin e librit në mënyra inovative dhe të përshtatshme për kohën tonë. Gjithashtu, përmes kësaj thirrjeje synojmë kultivimin e vlerave artistike e kulturore përmes krijimit të programeve të veçanta për nxitjen e krijimtarisë letrare dhe promovimit të leximit, identifikimit dhe mbështetjes së autorëve të rinj, aktivizimit të të rinjve në aktivitete të fushës së librit e leximit, rritjes së mbështetjes për autorët e pavarur.

Në funksion të prioritetit programor, thirrja për projekt-propozimet për mbështetjen e autorit për vitin 2025, synon mbështetjen e projekt-propozimeve të individëve në Republikën e Kosovës. Objektivat e përgjithshme të kësaj thirrjeje janë:

- Mbështetja për autorët e pavarur dhe identifikimi e promovimi i autorëve të rinj;
- Përhapja e kulturës së leximit nëpërmjet zhvillimit e zbatimit të programeve për nxitjen e lexueshmërisë për aktivizimin e të rinjve në fushën e librit e leximit;
- Zhvillim dhe funksionalizimi i kulturës së audio-librit në gjuhën shqipe;
- Hulumtimi artistik nëpërmjet programeve të rezidencave letrare për zhvillim të librave.

Projekt-propozimet e zhvilluara në përputhje me objektivat e përgjithshme dhe specifike duhet të synojnë gjithë përfshirjen, duke siguruar përfshirjen aktive të grupeve të ndryshme të komunitetit në aktivitetet përkatëse të projekt-propozimit, në veçanti të rinjtë, të moshuarit, vajzat dhe gratë, shkrimet në alfabetin brajl, shkrimet në gjuhët e komuniteteve, personat me aftësi të kufizuara, komunitetin LGBTIQ, komunitetet pakicë, etj.

Të drejtë aplikimi me projekt-propozime në thirrjen publike për mbështetjen e autorit për vitin 2025 kanë individët që dëshmojnë se programi i tyre i punës është i profilizuar në fushën e librit, leximit dhe kulturës. Individët mund të aplikojnë në një të njëzën nga kategoritë në vijim:

1. **Zhvillim, botim dhe përkthim i librave;**
2. **Programe për nxitjen e lexueshmërisë;**
3. **Zhvillim të audio-librit;**
4. **Rezidenca letrare.**

Individët apo OJQ-të mund të aplikojnë **vetëm në një të njëzën nga katër kategoritë** e kësaj thirrjeje publike me një projekt-propozim.

Kategoritë e thirrjes janë elaboruar më poshtë, duke zërthyer synimet dhe aktivitetet përkatëse, fushëveprimin, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për aplikuesit, si dhe shkallën e mbështetjes.

Vlerësimi i projekt-propozimeve do të zhvillohet në dy faza:

1. Vlerësimi administrativ - që identifikon nëse aplikuesi ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.

2. Vlerësimi përmbajtësor - që vlerëson nëse:

- aplikuesi është i profilizuar në fushën e librit dhe kulturës;
- aplikuesi ka aplikuar parimet e qeverisjes së mirë në zbatimin e programit përkatës në vitet paraprake;
- aplikuesi ka paraparë zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë në zbatimin e projekt-propozimit të prezantuar në këtë thirrje publike;
- aplikuesi posedon kapacitete profesionale dhe teknike për të zbatuar aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;
- janë përcaktuar pozitat e ekipit të projekt-propozimit dhe detyrimet e përgjegjësitë e tyre;
- projekt-propozimi përputhet me fushëveprimin e kësaj thirrjeje publike;

- projekt-propozimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse;
- aktivitetet e projekt-propozimit janë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;
- kostot e projekt-propozimit janë reale dhe në përputhje karshi rezultateve të planifikuara, çmimeve të tregut dhe kohëzgjatjes së planifikuar për zbatimin e aktiviteteve të projekt-propozimit.

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme apo të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse, aplikacioni do të konsiderohet i pakompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

Aplikimi:

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat janë në dispozicion në ueb-faqen e MKRS-së: www.mkrs-ks.org. Të interesuarit mund të aplikojnë vetëm përmes postës elektronike në email adresën: autori.mkrs@rks-gov.net

Titulli që duhet shënuar në subjekt të emailit:

Thirrja Publike për Mbështetjen e Autorit__Emri i Individit

Afati për aplikim:

Afati i fundit për aplikim është me datën: 4 Prill 2025.

Më shumë informacione rreth thirrjes publike:

Të gjitha çështjet që lidhen me ftesën publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: Pyet.autorin@rks-gov.net jo më vonë se pesë ditë para mbylljes së ftesës publike.

KATEGORIA E PARË:

Mbështetje për zhvillim, botim dhe përkthim të librave

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nëpërmjet kësaj kategorie synon të mbështes drejtpërdrejt krijimtarinë e autorit të pavarur që nga fazat e para të zhvillimit të veprës letrare deri në fazën e botimit dhe të promovimit të tij. Lehtësimi i depërtimit në treg nëpërmjet stimulimit të zhvillimit të autorëve të rinj, nxitjes së krijimtarisë letrare nëpërmjet mbështetjes së gjinive të ndryshme letrare dhe përkthimeve, dhe diversifikimi i tregut nëpërmjet rritjes së kualitetit në botim janë në qendër të mbështetjes së kategorisë së parë të kësaj thirrjeje.

Nëpërmjet ofrimit të mbështetjes së veçantë për zhvillim, botim dhe përkthim të librave për autorin e pavarur, synohet:

1. Zhvillimi i veprave që nga shkrimi deri në botim;
2. Botimi i librave të përfunduar por të pabotuar;
3. Identifikimi i autorëve të rinj nëpërmjet mbështetjes së zhvillimit të librave të parë;
4. Zhvillimi, afirmimi dhe promovimi i veprave të reja të gjinive të ndryshme letrare;
5. Përkthimi i veprave nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj dhe anasjelltas;
6. Diversifikimi dhe rritja e kualitetit të botimit;
7. Projekte të tjera në përputhje me objektivat e kësaj thirrjeje.

Kategoritë e botimeve që do të konsiderohen për mbështetje janë:

1. Letërsi;
2. Letërsi dokumentare/autobiografi;
3. Shkencë sociale;
4. Arte;
5. Arkitekturë;
6. Histori;
7. Roman grafik;
8. Publicistikë;
9. Për fëmijë.

*Inkurajohen projekt-propozimet me botim në alfabetin brajl dhe në gjuhët e komuniteteve etnike joshumicë që jetojnë në Kosovë.

Kush mund të aplikojë:

- Individët shtetas të Republikës së Kosovës të profilizuar në fushën e librit, të kulturës ose të kategorive të botimeve të listuara për mbështetje me këtë thirrje, me përvojë të dëshmuar në ato fusha dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

- Individët shtetas të Republikës së Kosovës si autorë të rinj ose të pabotuar më parë.

Kriteret e përgjithshme minimale janë:

- Të ofrojnë dëshmi të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës;
- Në rast se individi ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose të ketë pozitë të lartë drejtuese në institucionet vartëse të saj;

Kriteret e veçanta janë:

- Duhet të jenë të profilizuar në fushën e kulturës ose të kategorive të botimeve të listuara për mbështetje në këtë thirrje, me përvojë të dëshmuar në këto fusha nëpërmjet portfolios së punës dhe CV.
- Për autorët e rinj ose të pabotuar më parë, duhet të ofrohet portfolio me tre (3) mostra të punës letrare të mëparshme të cilat pasqyrojnë stilin dhe aftësinë në shkrim, të cilat nuk kanë nevojë të jenë të botuara më herët.

Dokumentet e nevojshme

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i Aplikacionit për projekt,
2. Formulari i Propozim buxhetit,
3. Formulari i deklaratës për financimit të dyfishtë,
4. Rezume të librit të propozuar për zhvillim, botim apo përkthim me titull të librit, përmbajtja e librit me minimum 300 fjalë dhe maksimum 500 fjalë, personazhet kryesore, volumi dhe tirazhi i paraparë për librin;
5. Dokumentacioni personal: Letërnjoftimi, CV-ja me përgatitje profesionale, portfolio e krijimtarisë.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Përfituesit e Projekt-propozimeve në këtë kategori duhet të zbatojnë projektet e tyre brenda një viti nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit: 15,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për përfituesit: N/A Euro

KATEGORIA E DYTË:

Programe të nxitjes së lexueshmërisë

Synimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është inkurajimi i një kulture të re të leximit në Kosovë dhe nxitja e interesimit të publikut për librat dhe letërsinë. Qëllimi i kësaj kategorie është të rrisë shkallën e leximit dhe interesit për librat në Kosovë. Kjo do të arrihet nëpërmjet zhvillimit të programeve inovative dhe të përshtatshme për të gjitha grupet e ndryshme të komunitetit, që do të nxisin lexueshmërinë dhe kulturën e leximit në mënyra të ndryshme.

Nëpërmjet ofrimit të mbështetjes së veçantë për programe të nxitjes së lexueshmërisë, synohet:

1. Promovimi, pasurimi dhe diversifikimi i jetës kulturore përmes aktiviteteve gjithëpërfshirëse në fushën e librit dhe lexueshmërisë;
2. Bashkëpunimi në zbatimin e programeve për rritjen e lexueshmërisë mes bibliotekave publike e private, institucione shkollore, qendra rinore e kulturore, organizata dhe nëpër institucione të tjera të librit OJQ-ve, individëve, bibliotekave komunale, qendrave të leximit dhe shkollave;
3. Rritje e qasjes në libra dhe materiale të tjera për komunitetet me nevoja të veçanta;
4. Rritja e numrit të hapësirave të funksionalizuara si hapësira për lexim;
5. Forcimi i rolit promovues e edukativ i qendrave të librit;
6. Nxitja e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve dhe personave me nevoja të veçanta nëpër fushata të librit e leximit;
7. Projekte të tjera të fushës së librit në përputhje me objektivat e kësaj thirrjeje.

Kush mund të aplikojë:

- Individët shtetas të Republikës së Kosovës të profilizuar në fushën e librit ose të kulturës me përvojë të dëshmuar në sektorin e librit ose të kulturës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.
- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës të profilizuara në fushën e librit ose të kulturës, me përvojë të dëshmuar në sektorin e librit ose të kulturës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme minimale për INDIVIDËT janë:

- Të ofrojnë dëshmi të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës;
- Në rast se individi ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose të ketë pozitë të lartë drejtuese në institucionet vartëse të saj.

Kriteret e veçanta për INDIVIDËT janë:

- Duhet të jenë të profilizuar në fushën e kulturës, me përvojë të dëshmuar të pjesëmarrjes aktive në krijimtari letrare, organizime të fushës së librit ose të kulturës në Republikën e Kosovës;
- Të ofrojnë portfolion me dëshmi të pjesëmarrjes aktive në krijimtari letrare, organizimit të aktiviteteve në fushën e librit ose të kulturës.

Dokumentet e nevojshme për INDIVIDË:

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i Aplikacionit për projekt,
2. Formulari i Propozim buxhetit,
3. Formulari i deklaratës për financimit të dyfishtë,
4. Dokumentacioni për individët: Letërnjoftimi, CV-ja me përgatitje profesionale, portfolio e krijimtarisë.

Kriteret e përgjithshme minimale për OJQ-të janë:

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projektpropozimit përkatës;

- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;
- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (dokumenti i lëshuar nga ATK dorëzohet nga përfituesi me rastin e nënshkrimit të kontratës);
- OJQ-ja duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike;
- Përfaqësuesi/ja i OJQ-së aplikante në emër të së cilit/cilës bëhet aplikimi, nuk ka të drejtë të aplikoj edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrjeje publike.

Kriteret e veçanta për OJQ-të janë:

- OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën e librit ose të kulturës, me përvojë të dëshmuar në organizimin e aktiviteteve që lidhen me afirmimin e librit ose të kulturës në Republikën e Kosovës. Në vlerësim mund të konsiderohet edhe përvoja individuale e anëtarëve të organizatës nëse OJQ-ja është e themeluar rishtazi;
- Të ofrojnë portfolion me dëshmi të aktiviteteve në fushën e librit ose kulturës.

Dokumentet e nevojshme për OJQ:

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i Aplikacionit për projekt,
2. Formulari i Propozim buxhetit,
3. Formulari i deklaratës për financimit të dyfishtë,
4. Formular i deklaratës se partneritetit, nese ka,
5. Forma e deklaratës se projekteve te financuara,
6. Dokumentacionet e OJQ-së: Certifikata e regjistrimit, certifikata e numrit fiskal, (certifikata e ATK për kryerjen e obligimeve tatimore që dorëzohet me rastin e nënshkrimit të kontratës),
7. Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës së aplikantit;
8. Portfolio që dëshmon përvojën në organizimin e aktiviteteve që lidhen me afirmimin e librit ose kulturës.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë kategori duhet të zbatohen deri më 31.12.2025.

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit: 10,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për përfituesit: N/A Euro

KATEGORIA E TRETË:

Zhvillim të audio-librit

Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit nëpërmjet kësaj kategorie të mbështetjes synon të inkurajoj afërsinë me letërsinë nëpërmjet mbështetjes së formave që lehtësojnë qasjen me librin. Nëpërmjet audio-librit, lexuesi dhe dëgjuesi e ka më afër kopjen digjitale të librit në formatin audio. Audio-libri është mënyrë e re e eksplorimit të librave, mirëpo shërben edhe si zgjidhje për personat me çrregullime në të lexuar, disleksi apo për personat e verbër.

Nëpërmjet ofrimit të mbështetjes së veçantë për zhvillim të audio-librit, synohet:

1. Promovim i librave në gjuhën shqipe përmes digjitalizimit të tyre në audio-libër;
2. Regjistrimi i librave klasik shqip në audio-libra dhe shpërndarja e tyre;
3. Regjistrimi i librave nga gjuhët e huaja në gjuhën shqipe;
4. Krijim i audio-librave të veçantë për personat me çrregullim në të lexuar, disleksi apo për personat e verbër;
5. Materiale të veçanta për mësimdhënie që synojnë ngritjen e kreativitetit, mësimin e gjuhëve të huaja, rritjen e efektivitetit në klasë, etj;
6. Projekte të tjera që lidhen me audio-librin dhe që janë në përputhje me objektivat e kësaj thirrjeje.

Kush mund të aplikojë:

- Individët shtetas të Republikës së Kosovës të profilizuar në fushën e librit ose të kulturës me përvojë të dëshmuar në sektorin e librit ose të kulturës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.
- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës të profilizuara në fushën e librit ose të kulturës, me përvojë të dëshmuar në sektorin e librit ose të kulturës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme minimale për INDIVIDËT të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të ofrojnë dëshmi të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës;
- Në rast se individi ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike;

- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose të ketë pozitë të lartë drejtuese në institucionet vartëse të saj.

Kriteret e veçanta për INDIVIDËT janë:

- Duhet të jenë të profilizuar në fushën e kulturës, me përvojë të dëshmuar të pjesëmarrjes aktive në krijimtari letrare apo organizime të fushës së librit ose kulturës në Republikën e Kosovës;
- Të ofrojnë portfolion me dëshmi të pjesëmarrjes aktive në krijimtari letrare, organizimit të aktiviteteve në fushën e librit ose të kulturës.

Dokumentet e nevojshme për INDIVIDË:

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i Aplikacionit për projekt,
2. Formulari i Propozim buxhetit,
3. Formulari i deklaratës për financim të dyfishtë,
4. Rezyme të librit të propozuar për digjitalizim në audio-libër, përmbajtja e librit me minimum 300 fjalë dhe maksimum 500 fjalë, personazhet kryesore, volumi i librit;
5. Dokumentacioni për individët: Letërnjoftimi, CV-ja me përgatitje profesionale, portfolio e krijimtarisë;

Kriteret e përgjithshme minimale për OJQ-të janë:

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projektpropozimit përkatës;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;

- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (dokumenti i lëshuar nga ATK dorëzohet nga përfituesi me rastin e nënshkrimit të kontratës);
- OJQ-ja duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike;
- Përfaqësuesi/ja i OJQ-së aplikante në emër të së cilit/cilës bëhet aplikimi, nuk ka të drejtë të aplikoj edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrjeje publike.

Kriteret e veçanta për OJQ-të janë:

- OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën e librit ose të kulturës, me përvojë të dëshmuar në organizimin e aktiviteteve që lidhen me afirmimin e librit ose të kulturës në Republikën e Kosovës. Në vlerësim mund të konsiderohet edhe përvoja individuale e anëtarëve të organizatës nëse OJQ-ja është e themeluar rishtazi;
- Të ofrojnë portfolion me dëshmi të aktiviteteve në fushën e librit ose kulturës.

Dokumentet e nevojshme për OJQ:

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i Aplikacionit për projekt,
2. Formulari i Propozim buxhetit,
3. Formulari i deklaratës për financimit të dyfishtë,
4. Formular i deklaratës se partneritetit,
5. Forma e deklaratës se projekteve të financuara,
6. Dokumentacionet e OJQ-së: Certifikata e regjistrimit, certifikata e numrit fiskal, (certifikata e ATK për kryerjen e obligimeve tatimore që dorëzohet me rastin e nënshkrimit të kontratës),
7. Rezume të librit të propozuar për digjitalizim në audio-libër, përmbajtja e librit me minimum 300 fjalë dhe maksimum 500 fjalë, personazhet kryesore, volumi i librit;
8. Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës së aplikantit;
9. Portfolio që dëshmon përvojën në organizimin e aktiviteteve që lidhen me afirmimin e librit ose kulturës.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë kategori duhet të zbatohen deri më 31.12.2025.

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit: 10,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për përfituesit: N/A Euro

KATEGORIA E KATËRT:

Rezidenca letrare

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit synon hapjen e mundësive për zhvillimin e projekteve letrare dhe artistike për autorët, poetët, përkthyesit, krijuesit dhe inovatorët e fushës së librit duke mbështetur ata në zhvillim e rezidencave letrare jashtë dhe brenda vendit. Mbështetja nëpërmjet kësaj kategorie do të mundësojë krijimin e mjedisit të nevojshëm për krijimtari letrare që mundëson shkëmbimin e ideve, marrjen e informacionit nëpërmjet hulumtimit në terren, eksplorimit të kulturave të reja, etj.

Në këtë kategori parashihet mbështetja e projekt-propozimeve të individëve të profilizuar në fushën e librit dhe kulturës, me synim:

- 1) Inkurajimi dhe mbështetja e krijuesve të rinj në prodhimin e veprave të tyre;
- 2) Mbështetja në zhvillimin e projekteve letrare dhe artistike;
- 3) Promovimi i letërsisë vendase dhe nxitja e dialogut dhe bashkëpunimit mes krijuesve vendas dhe të huaj;
- 4) Krijimi i një mjedisi kreativ dhe inovativ për krijuesit, duke i dhënë mundësinë për të punuar në një ambient të izoluar dhe inspirues;
- 5) Bashkëpunimi me komunitetin lokal dhe përfshirja në aktivitete kulturore të qytetit ose rajonit;
- 6) Krijimi i mundësive për krijuesit për të shkëmbyer idetë dhe përvojat e tyre me njëri-tjetrin dhe për të zhvilluar projekte të përbashkëta.

Kush mund të aplikojë:

- Individët shtetas të Republikës së Kosovës të profilizuar në fushën e librit dhe kulturës, me përvojë të dëshmuar në kuadër të sektorit të librit dhe kulturës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme minimale për INDIVIDËT janë:

- Të ofrojnë dëshmi të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës;
- Në rast se individi ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;

- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose të ketë pozitë të lartë drejtuese në institucionet vartëse të saj.

Kriteret e veçanta për INDIVIDËT janë:

- Duhet të jenë të profilizuar në fushën e kulturës, me përvojë të dëshmuar të pjesëmarrjes aktive në krijimtari letrare apo organizime të fushës së librit në Republikën e Kosovës;
- Të ofrojnë portofolio me dëshmi të pjesëmarrjes aktive në krijimtari letrare apo organizimit të aktiviteteve në fushën e librit;

Dokumentet e nevojshme

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i Aplikacionit për projekt,
2. Formulari i Propozim buxhetit,
3. Formulari i deklaratës për financimit të dyfishtë,
4. Letra e pranimit në programin e rezidencës letrare jashtë vendit (në rast që aplikohet),
5. Dokumentacioni për individët: Letërnjoftimi, CV-ja me përgatitje profesionale, portofolio e krijimtarisë.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë kategori duhet të zbatohen deri më 31.12.2025.

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit: 5,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për përfituesit: N/A Euro